

Vodafone GigaTV


Pyetje të Shpeshta

Contents

Si të përdor ndërfaqen kryesore të Vodafone TV?	3
Çfarë ofron secila prej zonave të Menusë?	4
Çfarë është një kod PIN?	6
Çfarë është kontrolli prindëror?	6
Cilat janë funksionalitetet OTT në Vodafone TV?.....	7
Sa pajisje mund të përdor me Vodafone TV?	7
Si mund të kërkoj për programe të ndryshme?.....	8
Çfarë janë kanalet OTT në Vodafone TV dhe cilat kanale përfshihen?	8
Si mund të shohësh detajet e programit?	8
Si mund të regjistros një program?	10
Sa orë përmbajtje mund të regjistroj?.....	10
Çfarë ndodh nëse arrin 90 orë regjistrime?.....	10
Pas sa kohësh do të fshihen programet e regjistruara?	10
Si mund të ndryshosh titrat ose audion të një programi?.....	10
A mund ta përdor llogarinë time ekzistuese në aplikacionin YouTube?.....	11
Për të përdor pajisjen Vodafone TV, a duhet të kem internetin e Kompanisë Vodafone?	11
Nëse nuk e lidh dekoderin me internetin, mund të shikoj VOD ose të përdor aplikacionet? ..	11
Si mund të lidh Vodafone TV?.....	11
Sa është shpejtësia minimale e internetit për të përdor funksionalitetet smart?	11
Nëse nuk jam klient mobile me Vodafone, a mund ta përdor aplikacionin mobile Vodafone GigaTV?	11
Si mund të hap llogarinë time nga aplikacioni në mobile?	11
A ofrohet falas dekoderi i ri (TV3)?.....	11
A ofron dekoderi i ri (TV3) më shumë përmbajtje/kanale?	11
Çfarë është e re në TV3?.....	12
Çfarë ndodh nëse klienti dëshiron të mbylle shërbimin?	12
A mund ta lidh pajisjen e re (TV3) pa kabell përmes WiFi?	12
A mund ta marr pajisjen e re me rinovimin e kontratës time? (Në raste kur klienti kërkon dekoderin e ri sepse e pa tek një mik/familjar).....	12
Si mund të kërkoj filma, seri, dokumentarë, etj.?.....	12
A mbështet dekoderi i ri komanda me zë?.....	12
A mund të shtoj një llogari të dytë Google?	12

Si të përdor ndërfaqen kryesore të Vodafone TV?

Pas konfigurimit fillestar, dekoderi i gjeneratës së tretë Gen3 do të hapet në këtë pamje.



Kjo është menu që mund të aksesosh nëpërmjet butonit Menu/Home në telekomandë. Ajo ofron akses në të gjitha zonat kryesore të ndërfaqes së përdoruesit.

1. Zonat e Menusë:
 - On TV
 - My Home
 - Video On Demand
 - Regjistrimet
 - Apps


Në secilën prej tyre mund të kalosh me telekomandë me butonat e shigjetave anësore.

2. Shortcuts për **eventet e hapura**. Eventet, kanalet ose aplikacionet e shkarkuara do të shfaqen në këtë pjesë të menusë.
3. **Guida TV**, përmban Guidën me të gjithë programet TV të ofruara në cdo kanal.
4. Për secilën nga zonat e menusë, këtu shfaqen evente ose **programe të shpejta**, për të hedhur një sy se çfarë kontenti përmban.
5. **Kërkimi**, për të kërkuar programe dhe evente që janë pjesë e Guidës programore ose Regjistrimeve tuaja.
6. **Njoftime** – Njoftime rreth përditësimeve të ndryshme nga Vodafone TV ose Android.
7. **Cilësimet/Settings**, për të ndryshuar kontrollat prindërore, vendosur PIN të ndryshëm dhe përcaktuar karakteristikat për Vodafone TV dhe për karakteristikat native të Android.
8. **Ora**
9. Video ne background


Ke nevojë për ndihmë? Ti do të gesh plot informacione ndihmëse për Vodafone GigaTV në www.vodafone.al Ose na kontakto direkt në WhatsApp në numrin 0699000140.

Çfarë ofron secila prej zonave të Menusë?

- **On TV** - Në TV është zona e menisë ku përdoruesi ka akses të lehtë dhe më të shpejtë në kanalet live që janë pjesë e paketës ku është i abonuar.
 - Guida TV zmadhohet dhe hapet për të ofruar të gjithë strukturën e programacionit të kanaleve.
 - Filtri i kanaleve, zmadhohet gjithashtu për pjesën e filtruar të kanaleve ('Me Të Shikuarat' dhe sipas Tematikës)




- **My Home:** Kjo është një zonë e fokusuar te PËRDORUESI, e cila shfaq përmbajtjet e tua të preferuara, regjistrimet, blerjet dhe rekomandimet e personalizuara. Ofron akses në:
 - Shiritin kryesor – 4 eventet e fundit të shikuar nga përdoruesi
 - Shortcuts
 - Katalogu:
 - Vazhdo shikimin
 - Wishlist
 - Regjistrime
- **On Demand:** Kjo zonë është e dedikuar për katalogun OnDemand. Ajo mund të shfaqë një përzierje përmbajtjesh, në varësi të definicionit për këtë zonë, p.sh. të fundit ose më të shikuarat.
Konfigurimet e mundshme dhe llojet e përmbajtjes:
 - Eventet e fundit VOD
 - Koleksione të ndryshme VOD
 - Abonime



- **Aplikacionet:** Zona e Aplikacioneve ofron akses në të gjitha aplikacionet e integruar, si dhe Play Store për të shkarkuar të gjitha aplikacionet që ofrohen në pajisjet Android.
- Ofron akses në:
 - Aplikacionet e integruara
 - Aplikacione të shkarkuara


Në të majtë të Shirimit të Aplikacioneve të Mia, përdoruesi do të ketë akses në rrjetin e përmbajtjes që shfaq të gjitha aplikacionet e instaluar në pajisje.



Ke nevojë për ndihmë? Ti do të gesh plot informacione ndihmëse për Vodafone GigaTV në www.vodafone.al Ose na kontakto direkt në WhatsApp në numrin 0699000140.

Çfarë është një kod PIN?

Kodi PIN është një numër katërshifror që mund të përdoret për funksionin e Kontrollit Prindëror ose për blerjet. Nëse është i aktivizuar. Kodi PIN mund të ndryshohet te Cilësimet/Kontrollet prindërore/Menaxho PIN-in, vlera e paracaktuar është (derisa të ndryshohet) 1234.



Çfarë është kontrolli prindëror?

Me "Kontrollet prindërore", ke mundësinë të kyçësh përmbajtje ose kanale duke futur një vlerësim moshe ose kufizim kanali, ose një PIN që mund ta përdorësh për ta zhbllokuar atë në çdo kohë. Kodi PIN mund të regjistrohet te Cilësimet/Kontrollet prindërore/Menaxho PIN-in, kodi PIN i parazgjedhur është 1234.

Opsionet e kontrollit prindëror sipas moshës: 0/12/18. Ato shoqërohen me sinjalistikën përkatëse.




Kur zgjidhni opsionet, një përshkrim i asaj kategorie shfaqet në ekran. Për shembull, nëse zgjidhni programe që nuk rekomandohen për fëmijët nën moshën 12 vjeç, kontrolli prindëror do të zbatohet gjithashtu për programet që nuk rekomandohen për ata nën moshën 16 ose 18 vjeç.

Tek cilësimet për të rriturit +18, mund të zgjedhësh nëse përmbajtja për programet për të rritur mund të shfaqet në Programin Televiziv me përshkrimin e përmbajtjes ose nëse duhet të jetë plotësisht e fshehur, dhe duhet vendosur PIN për të shfaqur përmbajtjen.

Gjithashtu ke mundësinë për të kyçur kanalet e përzgjedhur, pavarësisht nga vlerësimi i moshës, gjë që mund të bëhet te Cilësimet/Kontrollet prindërore/Kyç Kanalet. Më pas do t'ju duhet të vendosni kodin PIN për të 6ell kanalet e kyçura.

Ke nevojë për ndihmë? Ti do të gjeësh plot informacione ndihmëse për Vodafone GigaTV në www.vodafone.al Ose na kontakto direkt në WhatsApp në numrin 0699000140.



Cilat janë funksionalitetet OTT në Vodafone TV?

- Funksionalitetet ne 30 kanalet OTT si **Catch UP** – Zgjidhni TV Guide për të 7ell 7 ditët e fundit në 7ellula kanal. Përmbajtjet e 7 ditëve të fundit mund të shikohen, të dalluara nga një ikonë “Play” në ndryshem me programet që janë live në transmetim tani. **Restart** ju lejon të rifilloni programin që tashmë ka filluar, nga fillimi. Record ose **Regjistro** ju lejon të regjistroni dhe të ruani programet e dëshiruara.
- **Regjistrimet:** Mund të gjeni dhe menaxhoni regjistrimet tuaja: fshini, mbronni ose modifikoni regjistrimet që keni vendosur tashmë në zonën e My TV. Në **My TV**, lëviz poshtë me butonin e navigimit në telekomandë për të aksesuar: regjistrimet; një listë me përmbajtjen e preferuar; programe të filluara më parë, por jo të përfunduara.
- **Kids Mode** është një modalitet që lejon fëmijën tuaj të shikojë TV në mënyrë të sigurt. Në modalitetin Kids, fëmijët shohin vetëm shfaqjet e përshtatshme për ta sipas moshës së caktuar. Në këtë modalitet, mund të krijoni profile të shumta ku mund të vendosni moshën, emrin e fëmijës dhe të zgjidhni avatarin e tij. Përveç kësaj, prindi mund të caktojë një orar të rregullt të gjumit ose një kohëmatës me numërim mbrapsht për të fikur televizorin automatikisht. Kids Mode mund të aksesohet lehtësisht te Aplikacionet, në rreshtin e aplikacioneve të integruara.
- **Video On Demand**, nje bibliotekë e pasur me mbi 400 tituj filma, seriale për fëmijë dhe dokumentarë.
- Në seksionin **Apps**, mund të përdorësh aplikacionet e integruara tashmë, si YouTube, Amazon Prime, DaVinci Kids, Motorvision, France24. Krahasimisht mund të shkarkohen mijëra aplikacione të tjera nga Google Play Store.

Sa pajisje mund të përdor me Vodafone TV?

Mund të lidhësh gjithsej 4 pajisje me abonimin tënd Vodafone TV, ndër të cilat vetëm një pajisje TV me Box Vodafone TV 3 dhe 3 pajisje të tjera mobile/tablet. Pajisjet Mobile/Tablet mund të jenë Android ose IOS.

Shkimi njëkohësisht mundësohet në pajisjen tuaj TV dhe në 2 Aplikacione Mobile/Tablet njëkohësisht.

Për të shkarkuar aplikacionin Vodafone GigaTV për Mobile/Tablet kliko këtu: [Giga TV | Vodafone](#) ne Seksionin Shkarko Giga TV.

Si mund të kërkoj për programe të ndryshme?

Tek menuja kryesore kliko “Search” apo “Kërko” në cepin e sipërm majtas ose kliko “Lupen e kërkimit” në telekomandë. Do të shfaqet tastiera Android për të plotësuar kërkimin me text. Në pajisjen Vodafone TV 3 mundësohet edhe Kërkimi me Zë dhe me Tekst përmes Google Assistant për të siguruar:

- Pervoje maksimale të kërkimit duke ofruar të njëjtat rezultate për kërkimin me zë dhe me tekst
- Rezultatet edhe nga aplikacionet e palëve të treta

Kërkimi me Zë mund të arrihet:

- Afër: duke shtypur butonin e Voice në telekomandë
- Larg: duke thënë fjalën “Hey Google” (me butonin e Mikut të Mikrofonit në panelin e sipërm të kutisë të çaktivizuar)

Kërkimi me Zë nga Google Asistant është i mundur vetëm në Anglisht.

Çfarë janë kanalet OTT në Vodafone TV dhe cilat kanale përfshihen?

Kanalet pjesë të listës Paketa OTT kanë funksionalitete të veçanta për programet që transmetohen dhe përfshijnë gjithsej 30 kanale. Të gjitha programet e transmetuara kanë grupin e mëposhtëm të veçorive:

- Catch Up (mund të shikohen deri në 7 ditë në të kaluarën)
- Regjistrohen
- Fillo nga e para ose Restart
- Mund të shikohen në 8ellular apo tablet.
- Ndalo/Rifillo/Kalo përpara në programacionet e CatchUp

Kliko këtu për listën e plotë të kanaleve OTT [Përmbajtja dhe aplikacionet e GigaTV | Vodafone](#)

Si mund të shohësh detajet e programit?

Ndërsa shikon një program live, ose nëse zgjedh një program nga Programi Televiziv, shtyp butonin OK në telekomandë për të parë Informacionin e programit.


- Informacioni i Programit **Mini** është një ekran ndërmjetës që tregon informacion rreth përmbajtjes që po luhet aktualisht dhe mundësive kryesore të disponueshme për të (rifillim, aksesueshmëri, regjistrime), duke shfaqur ende përmbajtjen që po luhet në sfond.



- Informacioni i **Plote** i Programit ofron përdoruesve të gjitha detajet rreth çdo përmbajtjeje ose serie, të gjitha mundësitë për të shikuar/regjistruar/blerë dhe gjithashtu disa rekomandime për përmbajtje të ngjashme.

Informacioni i plotë mbi përmbajtjen shfaqet në Informacionin e Programit:

- Përshkrim i gjatë
- Të gjitha mundësitë për shikim;
- Të gjitha episodet e serisë;
- Përmbajtje të ngjashme sipas llojit dhe kastit & ekipit të produksionit;



Ke nevojë për ndihmë? Ti do të gjesh plot informacione ndihmëse për Vodafone GigaTV në www.vodafone.al Ose na kontakto direkt në WhatsApp në numrin 0699000140.

Si mund të regjistroh një program?

Pasi të ndezësh dekoderin, mund të hysh tek Programi Televiziv (TV Guide) nga menyja kryesore ose duke shtypur butonin MENU në telekomandë dhe duke zgjedhur artikullin e menisë Programi Televiziv. Tek Programi Televiziv, përdor shigjetat dhe butonat e navigimit në telekomandë për të gjetur programin që dëshiron të regjistroh, më pas shtyp butonin OK dhe kliko butonin 'Regjistro'.

Për seritë, është e mundur të vendosësh regjistrimin e të gjithë serisë ose të regjistroh vetëm episode individuale. Mund të përdorësh gjithashtu <butonin e regjistrimit në mes, të shënuar me një 'R' në një rreth të kuq> në telekomandë, i cili lejon të regjistroh të gjithë programin që aktualisht po transmetohet.

Në rastin e programeve individuale, shtypja e butonit 'R' një herë do të regjistrojë programin, duke e shtypur dy herë do ta anulojë regjistrimin. Për seritë: shtyp një herë për të regjistruar të gjithë serinë, shtyp dy herë për të regjistruar vetëm episodin, shtyp një herë të tretë për të fshirë/regjistruar.

Regjistrimi i programeve është i mundur vetëm në kanalet me funksionalitete OTT. Hapja e menisë në programin që po ndjek (duke shtypur OK) të tregon të gjitha funksionalitetet e mundshme për atë program.

Sa orë përmbajtje mund të regjistroj?

Mund të regjistroh 90 orë në total, të cilat mund t'i ruash deri në 90 ditë. Te "Cilësimet/Cilësimet e përmbajtjes"/"Regjistrimet" mund të zbulosh se sa orë janë regjistruar deri tani. Regjistrimet tuaja ruhen në cloud, të cilat mund t'i aksesosh në shtëpi nepërmjet dekoderit ose edhe kur je në lëvizje nga celulari ose tableti nga aplikacioni Vodafone Giga TV.

Çfarë ndodh nëse arrin 90 orë regjistrime?

Nëse arrin 90 orë dhe konfiguroni një regjistrim të ri, hapësira ruajtëse do të optimizohet dhe programet më të vjetra të regjistruara do të fshihen në mënyrë që regjistrimi i ri të mund të bëhet. Nëse ke përmbajtje të vjetër, por dëshiron ta ruash dhe nuk dëshiron që të fshihet automatikisht, mund ta mbron atë regjistrim. Për ta bërë këtë, shko te Regjistrimet dhe zgjidh Mbro Regjistrimin pranë atij regjistrimi, në mënyrë që të mund ta ruash atë regjistrim deri në 90 ditë. Sigurisht, një regjistrim i mbrojtur mund të fshihet manualisht në të njëjtën mënyrë me opsionin Fshi Regjistrimin.

Pas sa kohësh do të fshihen programet e regjistruara?

Mund të regjistroh gjithsej 90 orë, nëse arrini këtë kufi, përmbajtja më e vjetër e regjistruar do të zëvendësohet automatikisht me regjistrimin më të ri. Regjistrimet më të vjetra se 90 ditë do të fshihen automatikisht pavarësisht nëse hapësira e ruajtjes është plot.

Si mund të ndryshosh titrat ose audion të një programi?

Për të ndryshuar titrat ose gjuhën audio të një programi, shtyp OK në telekomandë për të shfaqur detajet e programit. Mund të gjeësh titrat e disponueshme nën butonin Titra dhe gjuhët nën butonin Audio, dhe aty mund t'i ndryshosh. Mund t'i ruash gjithashtu titrat automatikisht, pavarësisht nga kanali, tek Cilësimet/Aksesueshmëria/Titrat. Cilësimi i ruajtur këtu do të vendoset për të gjitha kanalet dhe aty ku gjuha e përzgjedhur është e disponueshme, ky do të jetë cilësimi i paracaktuar.

A mund ta përdor llogarinë time ekzistuese në aplikacionin YouTube?

Nëse keni një llogari të regjistruar më parë në YouTube, mund të identifikoheni në të edhe përmes aplikacionit YouTube në Vodafone TV me emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin ose mund të fillosh një regjistrim të ri përmes televizorit. Gjithashtu mund ta përdorësh aplikacionin pa regjistrim.

Për të përdor pajisjen Vodafone TV, a duhet të kem internetin e Kompanisë Vodafone?

Jo. Dekoderi Vodafone TV është një dekoder kabllor që sinjalin e kanaleve e merr nga instalimi kabllor. Për të aksesuar funksionalitetet OTT dekoderi ka nevojë edhe për Internet. Ky internet mund të jetë shërbim i ofruar nga Vodafone TV (për të siguruar shërbimin më të mirë ju sugjerojmë këtë), por pajisja funksionon lehtësisht me cdo operator tjetër internet.

Nëse nuk e lidh dekoderin me internetin, mund të shikoj VOD ose të përdor aplikacionet?

Jo, për të aksesuar VOD, aplikacionet apo kanalet interactive duhet të ketë lidhje me internetin.

Si mund të lidh Vodafone TV?

Dekoderi Vodafone TV mund të lidhet me një televizor vetëm me HDMI. Dekoderi Vodafone TV duhet të lidhet gjithashtu me rrjetin kabllor të Vodafone dhe me ushqyesin e energjisë elektrike. Ky decoder mund të përdoret me LAN ose me ëireless për funksionalitetet OTT. Për më shumë informacion, në kutinë tuaj Vodafone TV 3 gjeni një Udhëzues me të gjitha instruksionet për lidhjen e pajisjes tuaj.

Sa është shpejtësia minimale e internetit për të përdor funksionalitetet smart?

Minimumi i shpejtësisë është 8 Mbps, por për një eksperiencë sa më të mirë ju sugjerojmë 50 Mbps.

Nëse nuk jam klient mobile me Vodafone, a mund ta përdor aplikacionin mobile Vodafone GigaTV?

Po, por duhet të kesh një abonim aktiv Vodafone GigaTV.

Si mund të hap llogarinë time nga aplikacioni në mobile?

Username: CASID (e gjeni tek kutia e pajisjes)

Passëord: një password unik që e merrni në momentin e aktivizimit në dyqan

Username dhe passëord dërgohen automatikisht me SMS me krijimin e kontrates TV.

A ofrohet falas dekoderi i ri (TV3)?

Po, si modeli i mëparshëm, pajisja do t'i ofrohet klientit falas dhe do të përdoret vetëm për shërbimin gjatë periudhës së Marrëveshjes me Klientin.

A ofron dekoderi i ri (TV3) më shumë përmbajtje/kanale?

Jo, pajisja e re përfshin të njëjtën përmbajtje, si kanale ashtu edhe seri/filma, etj.

Ke nevojë për ndihmë? Ti do të gresh plot informacione ndihmëse për Vodafone GigaTV në www.vodafone.al Ose na kontakto direkt në WhatsApp në numrin 0699000140.

Çfarë është e re në TV3?

Dekoderi i ri ka një ndërfaqe grafike të rinovuar, ndërkohë që ofron gjithashtu akses në Google Play, ku mund të shkarkoni aplikacione shtesë.

Çfarë ndodh nëse klienti dëshiron të mbylle shërbimin?

Ashtu si me modelin e mëparshëm, nëse periudha 12-24-mujore e kontrates nuk ka përfunduar dhe pajisja nuk është dëmtuar, abonenti duhet ta kthejë pajisjen.

A mund ta lidh pajisjen e re (TV3) pa kabell përmes WiFi?

Po, dekoderi mund të lidhet gjithashtu pa kabell përmes WiFi për përdorimin e internetit.

A mund ta marr pajisjen e re me rinovimin e kontratës time? (Në raste kur klienti kërkon dekodern e ri sepse e pa tek një mik/familjar)

Po, përmes procesit të Ndryshimit të Pajisjes në CRM, klienti mund të përmirësojë ose të bëjë një upsell për pajisjen GEN3 ose TV3.

Si mund të kërkoj filma, seri, dokumentarë, etj.?

Nga ekrani kryesor i menuesë në fushën e "kërkimit" (ikona e lupës).

A mbështet dekoderi i ri komanda me zë?

Po, përmes Google Assistant lite, megjithatë komandat duhet të jenë në anglisht. Google nuk e mbështet plotësisht shqipen si gjuhë për komandat me zë.

A mund të shtoj një llogari të dytë Google?

Po, megjithatë do të lidhet një llogari Google çdo herë.